REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.3037/1 Prot.

Maliq, më 20.05.2026

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ
KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, *"Funksionimi i këshillit bashkiak"*, pika 2, pika 4 dhe 5, neni 56 *"Kryetari i këshillit bashkiak"* pika 2 gërma "a", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, *"Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq"* ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të këshillit ditën e premte, **më datë 29.05.2026, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:(Paraprak)

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë (30.04.2026)
4.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin prill 2026";
5.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë"
6.P-V"Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.S.K banues në Fshatin Vloçisht Nj.A Libonik, banesa e të cilit u dogj si shkak i rënies të zjarrit";
7.P-V "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.2.datë, 08.01.2026 *"Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të adminstratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera për vitin 2026";* i ndryshuar.
8.P-V "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.146, datë 24.12.2025, *"Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në bashkinë Maliq, penalitetet dhe shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2026";*
9.P-V "Për miratimin e Raportit të I-rë të Monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2026";
10.P-V "Për miratimin e programit të transparencës të Bashkisë Maliq";
11.P-V"Për miratimin në parim për dhënien në përdroim të fondit pyjor, për ndërtimin e Kullave Eolike nga Kompania *"WP MORAVA"* shpk.";
12.Prezantimi i Raportit të Performancës për Bashkinë Maliq viti 2025.
13.Diskutime të tjera.

Shënim: Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit do të mbahen ditën e enjte me datë 28.05.2026 nga ora 10:00-13:00 si më poshtë:

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut. Pikat 4, 5 të rendit të ditës:

z.Faslli Zholli, znj.Gentiana Drabo, z.Armando Dautllari, z.Plator Çollaku, znj.Marjeta Xhelollari

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare. Pikat 7, 8, 9, 11 të rendit të ditës: z.Petrit Kupe, znj.Pranvera Begolli, znj.Marianthi Avrami, znj.Eglantina Balli, z.Andonaq Risto.

Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit.
Pika 6 e rendit të ditës z.Dritan Çami, z.Ilia Xhuti, znj.Floreta Zaçe, z.Faslli Zholi, z.Yllson Ibrahimllari

Komisioni Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare. Pika 10 e rendit të ditës: znj.Pranvera Begolli, z.Petrit Kupe, z.Kristina Malelli, z.Yllson Ibrahimllari, znj.Eglantina Balli.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI